


01-2415



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
**Komuna e Prishtinës**  
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110 dt.31.05.2012, nenit 21 & 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-03 dt.21.06.2016, nenit 17, pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt. 20.02.2008, nenit 15 pika "d" e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt. 23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, Vendimit 01nr.031 – 185481 dt.14.08.2015 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05nr.350/02 – 175921/25 dt.19.11.2025 (sipas eLeja KKN – 697), të kërkuësve: Pronarëve, Sebahadin Selmani, Ismet, Sadije, Latif, Raif, Adnan, Fitim, Burim, Jeton dhe Lulzim Mulolli, Nehat Bajrami, Shefki Rexhepi, Ana Orlovic, Enver dhe Nura Nura, Gafur, Isa dhe Ismail Shala, Ergun Bektesh, Eren, Fevzane, Enver dhe Jener Bekteshi, Belxhyzar Mustafa, Merzuqe Koseoglu, Nefise Veliu, Merita Rushiti, Hysejn dhe Kemal Dobrçani, Nexhat dhe Murat Mehmeti, Memet Maçastena, Safet, Nura, dhe Enver Maçastena, Milaim, Bedri dhe Arben Tahiri, Arif Begolli, Edheme Zeneli, Afrim dhe Agim Bulliqi, Lavdim Kastrati, dhe "IDEA Construction" sh.p.k. nga Prishtina, dhe me Investitor "IDEA Construction"sh.p.k. nga Prishtina, rr. "Malush Kosova", p.n., me certifikatë të biznesit ARBK 810028820, dhe me përfaqësues Nazmi Fetahu nga Prishtina, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e Kompleksit me ndërtesa shumë banesore & afariste – **Ndërtesa "A" & "B"** me 2B+P+10 (me aplikim të "Arkitekturë e qëndrueshme"), në kuadër të parcelës ndërtimore të pjesës së Blloku urban "T5", të Planit Rregullues "Tophane" dhe Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt për vendosjen e çështjes administrative, me datë 14.05.2026, merr këtë:

**V E N D I M**  
**CAKTIMI I KUSHTEVE NDËRTIMORE**

**I. I caktohen kushtet ndërtimore** kërkuësve: Pronarëve, Sebahadin Selmani, Ismet, Sadije, Latif, Raif, Adnan, Fitim, Burim, Jeton dhe Lulzim Mulolli, Nehat Bajrami, Shefki Rexhepi, Ana Orlovic, Enver dhe Nura Nura, Gafur, Isa dhe Ismail Shala, Ergun Bektesh, Eren, Fevzane, Enver dhe Jener Bekteshi, Belxhyzar Mustafa, Merzuqe Koseoglu, Nefise Veliu, Merita Rushiti, Hysejn dhe Kemal Dobrçani, Nexhat dhe Murat Mehmeti, Memet Maçastena, Safet, Nura, dhe Enver Maçastena, Milaim, Bedri dhe Arben Tahiri, Arif Begolli, Edheme Zeneli, Afrim dhe Agim Bulliqi, Lavdim Kastrati, dhe "IDEA Construction" sh.p.k. nga Prishtina, dhe me Investitor "IDEA Construction"sh.p.k. nga Prishtina, me certifikatë të biznesit ARBK 810028820, dhe me përfaqësues Nazmi Fetahu nga Prishtina, sipas kërkesës 05nr.350/02–175921/25 dt.19.11.2025 (sipas eLeja, KKN–697), për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e Kompleksit me ndërtesa shumë banesore & afariste – **Ndërtesa, "A" & "B"** me 2B+P+10 (me aplikim të "Arkitekturë e qëndrueshme"), në kuadër të parcelës ndërtimore të pjesës së Blloku urban "T5", të Planit Rregullues "Tophane" dhe PZHU-së në Prishtinë, konkretisht në parcelat kadastrale: **nr.4196-0; nr.4197-0, nr.4198-1, nr.4198-2, nr.4199-0, nr.4200-0, nr.4201-0, nr.4202-0, nr.4203-0, nr.4204-0, nr.4205-0, nr.4207-0, nr.4208-0, nr.4209-0, nr.4210-2, & nr.10353-1** ZK Prishtinë, dhe me trajtim, përmes transferit të së drejtës ndërtimore, të pjesës së parcelës kadastrale, **nr.10353-6** ZK Prishtinë, sipas projekt propozimit konceptual dhe "zgjidhja urbane", të prezantuar.

**II. Lokacioni** për të cilin caktohen kushtet ndërtimore përfshihet në kuadër të Planit Rregullues "Tophane" në Prishtinë, miratuar me Vendimin e KK Prishtinë 01nr.35-579 dt.22.11.2005, dhe plotësuar me Vendimin për plotësimin dhe mënyrën e realizimit të Planit Rregullues Urban "Tophane" 01 nr. 35-374 dt. 03.04.2008, ku sipas këtij plani kjo zonë është me destinim "zonë me destinim të

përzier", si dhe në Planin Zhvillimor Urban, miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01nr. 035-181427 dt. 24.09.2013, në zonë të destinuar për "ndërtim i lartë i përzier".

Për kriteret, parametrat urban dhe kushtet e ndërtimit, sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor, kërkuesit janë informuar përmes "Informim nga Plani Rregullues "Tophane" dhe PZHU" me referencë 04nr.350/01-70566/23 dt.14.04.2023, lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik e Komunës së Prishtinës.

**III. Gjendja ekzistuese** e lokacionit / parcelave, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

• Numri, sipërfaqja, pronari & klasa e kualitetit të parcelave kadastrale, janë:

- nr.4196-0; S=192m <sup>2</sup> ;	Sebahadin Selmani;	"Tokë ndërtimore";
- nr.4197-0; S=372m <sup>2</sup> ;	Ismet, Sadije, Latif, Raif, Adnan, Fitim, Burim, Jeton, Lulzim Mulolli;	"Tokë ndërtimore";
- nr.4198-1; S=88m <sup>2</sup> ;	Shefki Rexhepi;	"Tokë ndërtimore";
- nr.4198-2; S=75m <sup>2</sup> ;	Nehat Bajrami;	"Tokë ndërtimore";
- nr.4199-0; S=186m <sup>2</sup> ;	Ana Orlovic, Enver & Nura Nura, & "Idea Construction"sh.p.k.	"Tokë ndërtimore";
- nr.4200-0; S=257m <sup>2</sup> ;	Gafur, Isa, Ismail Shala;	"Tokë ndërtimore";
- nr.4201-0; S=81m <sup>2</sup> ;	Ergun Bektesh, Eren, Fevzane, Enver & Jener Bekteshi, Belxhyzare Mustafa, Merzuqe Koseoglu.	"Tokë ndërtimore";
- nr.4202-0; S=70m <sup>2</sup> ;	Nefise Veliu;	"Tokë ndërtimore";
- nr.4203-0; S=280m <sup>2</sup> ;	Merita Rushiti, Hysejn & Kemal Doberçani;	"Tokë ndërtimore";
- nr.4204-0; S=287m <sup>2</sup> ;	Nexhat & Murat Mehmeti;	"Tokë ndërtimore";
- nr.4205-0; S=209m <sup>2</sup> ;	Safet, Nura, & Enver Maqastena, Memet Maqastena.	"Tokë ndërtimore";
- nr.4207-0; S=338m <sup>2</sup> ;	Milaim, Bedri & Arben Tahiri;	"Tokë ndërtimore";
- nr.4208-0; S=403m <sup>2</sup> ;	Arif Begolli, Edheme Zeneli;	"Tokë ndërtimore";
- nr.4209-0; S=234m <sup>2</sup> ;	Afrim & Agim Bulliqi;	"Tokë ndërtimore";
- nr.4210-2; S=283m <sup>2</sup> ;	Lavdim Kastrati;	"Tokë ndërtimore";
- nr.10353-1; S=2m <sup>2</sup> ;	"Idea Construction"sh.p.k.;	"Tokë ndërtimore";
- nr.10353-6; S=76m <sup>2</sup> (nga totali S=157m <sup>2</sup> );	"Idea Construction"sh.p.k.;	"Tokë ndërtimore";

**Totali i parcelave: S=3,433m<sup>2</sup>;**

- Parcelat kadastrale të lartcekura janë në pronësi të pronarëve privat, gjegjësisht e drejta pronësoro-juridike është private-tokë e ndërtuar, si dhe të njëjtat janë me kyçje në infrastrukturë teknike rrugë, ujësjellës, kanalizim, elektrikë dhe telefoni,
- Në kuadër të parcelave kadastrale të lartcekura përfshihen/shtrihen disa ndërtesa individuale banimore / shtëpi familjare, me etazhitet P+2;
- Terreni i lokacionit, ka pjerrtësi të vogël në drejtimin jug-perëndim, me disnivel ~0.7m';
- Parcelat kadastrale të lartcekura, kanë qasje nga rrugët "Mehmet Pashë Deralla" dhe përmes kësaj në rrugën "Murat Mehmeti";
- Në diametër prej 50m' të lokacionit, përfshihen kryesisht ndërtesa individuale banimore, si dhe një ndërtesë shumë banesore dhe afariste.

**IV. Kushtet ndërtimore** për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor dhe rregullimin e hapësirës sipas gjendjes së planifikuar për realizimin/ndërtimin e Kompleksit me ndërtesa shumë banesore & afariste– **Ndërtesa "A" & "B"** me 2B+P+10 (me aplikim të "Arkitekturë e qëndrueshme"), në kuadër të parcelës ndërtimore të pjesës së Blloku urban "T5", të Planit Rregullues "Tophane" në Prishtinë, përcaktohen duke konsultuar, analizuar, si dhe mbështetur në dokumentet e planifikimit hapësinor, projekt propozimin e prezantuar, gjendjen ekzistuese të lokacionit dhe rregullativën ligjore në fuqi, dhe ato janë:

- Organizimi, gabaritet, pozicionimi, etazhiteti i ndërtesës dhe raporti i saj me distancat nga kufiri i parcelave, rrugët e planifikuara, parcela ndërtimore e bllokut urban, si dhe kushtet tjera, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Plani i situacionit – "zgjidhja urbane", bashkëngjitur vendimit të kushteve ndërtimore;

• Parcelat dhe pjesët e parcelave kadastrale me sipërfaqet e trajtuara, për realizimin e kompleksit me ndërtesa shumë banesore & afariste-**Ndërtesa "A" & "B"** me 2B+P+10 (me aplikim të "Arkitekturë e qëndrueshme"); konkretisht parcelat ndërtimore të përfshira në ndërtim - brenda vijës rregulluese, janë:

- nr.4196-0;	S=129m <sup>2</sup> ;
- nr.4197-0;	S=249m <sup>2</sup> ;
- nr.4198-1;	S=46m <sup>2</sup> ;
- nr.4198-2;	S=36m <sup>2</sup> ;
- nr.4199-0;	S=160m <sup>2</sup> ;

- nr.4200-0; S=220m<sup>2</sup>;
- nr.4201-0; S=32m<sup>2</sup>;
- nr.4202-0; S=2m<sup>2</sup>;
- nr.4203-0; S=260m<sup>2</sup>;
- nr.4204-0; S=283m<sup>2</sup>;
- nr.4205-0; S=208m<sup>2</sup>;
- nr.4207-0; S=314m<sup>2</sup>;
- nr.4208-0; S=403m<sup>2</sup>;
- nr.4209-0; S=234m<sup>2</sup>;
- nr.4210-2; S=283m<sup>2</sup>;
- nr.10353-1; S=2m<sup>2</sup>;
- nr.10353-6; S=0.00 m<sup>2</sup>;

**Totali: S=2,861m<sup>2</sup>;**

- Pjesët dhe parcelat kadastrale me sipërfaqe të trajtuara, për realizimin e kompleksit me ndërtesë shumë banesore & afariste – **Ndërtesa “A” & “B”** me 2B+P+10 (*me aplikim të “Arkitekturë e qëndrueshme”*), që shtrihen në hapësira publike të planifikuara, konkretisht jashtë vijës rregulluese, janë:

- nr.4196-0; S=63m<sup>2</sup>;
- nr.4197-0; S=123m<sup>2</sup>;
- nr.4198-1; S=42m<sup>2</sup>;
- nr.4198-2; S=39m<sup>2</sup>;
- nr.4199-0; S=26m<sup>2</sup>;
- nr.4200-0; S=37m<sup>2</sup>;
- nr.4201-0; S=49m<sup>2</sup>;
- nr.4202-0; S=68m<sup>2</sup>;
- nr.4203-0; S=20m<sup>2</sup>;
- nr.4204-0; S=4m<sup>2</sup>;
- nr.4205-0; S=1m<sup>2</sup>;
- nr.4207-0; S=24m<sup>2</sup>;
- nr.4208-0; S=0.00m<sup>2</sup>;
- nr.4209-0; S=0.00m<sup>2</sup>;
- nr.4210-2; S=0.00m<sup>2</sup>;
- nr.10353-1; S=0.00m<sup>2</sup>;
- nr.10353-6; S=76m<sup>2</sup>;

*/ trajtohet përmes transferit të së drejtës ndërtimore /*

**Totali: S=572m<sup>2</sup>;**

- Me këto kushte ndërtimore në kuadër të parcelës ndërtimore të pjesës së Blloku urban “T5”, të Planit Rregullues “Tophane” dhe PZHU-së në Prishtinë, është planifikuar të ndërtohet Kompleksi me ndërtesa shumë banesore & afariste – **Ndërtesa “A” & “B”** me 2B+P+10 (*me aplikim të “Arkitekturë e qëndrueshme”*), me sipërfaqe ndërtimore dhe etazhitet, sipas kalkulimeve dhe projekt propozimit, si në vijim:

**Kompleksi me ndërtesa shumë banesore & afariste – Ndërtesa “A” & “B”:**

**Ndërtesa - “A” - S=8,690.86m<sup>2</sup> / 6,610.86m<sup>2</sup>, mbi tokë + 2,080.00m<sup>2</sup>, nën tokë /,**

**Etazhitet: 2B+P+10;**

**Ndërtesa - “B” - S=8,474.33m<sup>2</sup> / 7,121.13m<sup>2</sup>, mbi tokë + 1,353.20m<sup>2</sup>, nën tokë /,**

**Etazhitet: 2B+P+10;**

**Totali: Ndërtesa “A” & “B”: S=17,165.20m<sup>2</sup> / 13,732m<sup>2</sup>, mbi tokë + 3,433.20m<sup>2</sup>, nën tokë /.**

- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës kadastrale-parcelës ndërtimore (ISHP), konkretisht shfrytëzimi i parcelës brenda vijës rregulluese, për vendosjen e ndërtesave në bazën-gabaritin e përdhësës ose suteranit është max. 0.40 (40 %), dhe sipas llogarive, projekt propozimit dhe e miratuar, kjo sipërfaqe është:

S=2,861 x 0.4=1,144.40m<sup>2</sup>, / lejuar për sipas planit rregullues /,

S=2,861x 0.5=1,430.50 / me aplikim të “Arkitekturë e qëndrueshme” /

S=1,410m<sup>2</sup> / sipas projekt propozimit /.

- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore / parcelave të bashkuara (ISHPN), për vendosjen e ndërtesës në bazë - gabarit të bodrumit, është max.60%, bazuar në paragrafin II. pika 1. të Vendimit 01nr.031–185481 dt.14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, dhe sipas llogarive, kjo sipërfaqe është:

S=2,861 x 0.6=1,716.60m<sup>2</sup>, / lejuar për sipas Vendimit të Kryetarit /,

S=1,716.60m<sup>2</sup> / sipas projekt propozimit /.

- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore / parcelave të bashkuara, për hapësira gjelbëruese (ISHPGJ), bazuar në paragrafin II. pika 2. të Vendimit 01 nr. 031-185481 dt. 14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, është min.40%, dhe përjashtimisht kur ndërtohet kulmi me gjelbërim, 0.3 (30 %), me gjelbërim të lartë dhe të ultë, si dhe hapësira të organizuara për sport dhe rekreacion, dhe sipas llogarive, kjo sipërfaqe është:  
 $S=2,861 \times 0.4=1.144.40m^2$ , / sipas Vendimit të Kryetarit /,  
 $S=1,350m^2$  / sipas projekt propozimit duke llogaritur edhe terasat – kulmet e gjelbër /.
- Koeficienti i ndërtimit (ISPN) për bllokun urban "T5", sipas kritereve të Planit Rregullues "Tophane" dhe atyre të përcaktuara sipas Vendimit 01 nr. 35–374 dt. 03.04.2008, është max. 4.0.  
 Trajtimi i sipërfaqeve ndërtimore për etazhet ndërtimore do të bëhet-llogaritet, si në vijim: **100%** për etazhet mbi kuotën  $\pm 0.00$ , 50% për etazhet me vëllim mbi **51%** apo së paku njëra ballore mbi nivelin e tokës-**suteren**, dhe **0%** për etazhet e nëntokës – **bodrum**, dhe sipas llogarive, projekt propozimit dhe e miratuar, kjo sipërfaqe është:  
 $S=2,861 \times 4.0=11,444m^2$  / lejuar për sipas planit rregullues /,  
 $S=13,732m^2$ , /sipas projekt propozimit, duke llogaritur edhe kompensimi-shpronësimin /.
- Me aplikimin e Vendimit 14nr.464/01-97987/22 dt.05.05.2022 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, për kompensimin e pronës private, të planifikuar për interes publik, me koeficient të ndërtimit, do të mundësohet që sipërfaqja e parcelës ndërtimore (brenda vijës rregulluese) të shtohet deri në 20 % të sipërfaqes së përgjithshme të parcelës ndërtimore, dhe për sipërfaqen  $S=572m^2$ , e përfshirë jashtë vijës rregulluese, kjo sipërfaqe, e përcaktuar në përqindje (%) është:  $S=572/2,861 \times 100=19.99$  %. Sipas kësaj llogarie, pronarët dhe investitori, për sipërfaqen e theksuar, do të kompensohen me sipërfaqen ndërtimore, llogaritur me koeficient të ndërtimit 4.0, si në vijim:  $S=572 \times 4.0=2,288m^2$ , ndërsa sipërfaqja e përgjithshme, e lejuar për ndërtim, për Kompleksin me ndërtesa shumë banesore, afariste-**Ndërtesa "A" & "B"** me 2B+P+10, do të jetë: **S=11,444 + 2,288=13,732m<sup>2</sup>**.
- Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesës të jetë "zonë mikse", gjegjësisht banim shumë banesor & afarizëm, si dhe hapësirat përcjellëse, si: kthina teknike, depo, dhe hapësira garazheve, etj. (sipas projekt propozimit të prezantuar);
- Etazhiteti maksimal i lejuar në bllokun urban "T5" është i pa kufizuar, sipas Vendimit 01 nr. 35–374 dt. 03.04.2008;
- Distanca e ndërtesës nga ngastrat kadastrorë me fqinjët të jetë 0.3H (ku H është lartësia maksimale e ndërtesës), ose me pëlqimin e fqinjëve mund të ndërtohet në kufi të parcelave, si dhe nëse fasadë ka fqinji ka hapje vetëm për kthina, si: banjë, wc, kthinë (shpajz), depo, shkallë, atëherë distanca minimale mund të jetë 300cm.
- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt. 14.08.2016 dhe protokolluar me numrin 01 nr. 031-185481, për shkaqe të kursimit dhe efijencës së energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejës ndërtimore;
- Ngritja minimale e etazhit të përdhesis nga terreni të jetë 1.40m’;
- Në objekte lejohen daljet me konzolë (nga etazhi i dytë e tutje) max. 140cm në të gjitha anët e objektit, por duke pasur parasysh që kjo dalje të llogaritet në distancën e objektit me fqinjin;
- Qasja në kompleks të jetë nga rruga e planifikuar e planit rregullues, të prezantuar në Planin e situacionit - "zgjidhja urbane" të kompleksit;
- Në kuadër të ngastrave, përveç parkingjeve, rrugëve, shtigjeve, etj., të parashihen edhe hapësira gjelbëruese dhe atë min.20% të hapësirës së mbetur që nuk është nën objekt;
- Në objektet shumëkatësh etazhi përdhese nuk lejohet për banim;
- Bodrumi i objektit mund të jetë jashtë gabaritit të objektit, por jo të dal në hapësirën publike (e definuar sipas planit). Pjesa e bodrumit që dël jashtë gabaritit, duhet të jetë në ose nën nivel të terrenit;
- Për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi, standardi i parkimit respektivisht i garazhimit, sipas Planit Rregullues "Tophane", është 1.5 VP/1 njësi banimi, ose min. 1 VP/njësi banimi, sipas Rregullore MMPH Nr.03/2016 mbi normat minimale teknike për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi. Për pjesën e afarizmit të parashihen min. 1VP për 40m<sup>2</sup> sipërfaqe neto për afarizëm. Garazhet e ndërtesave kolektive të banimit vendosen në apo nën ndërtesa, në gabaritin e ndërtesës, apo nën tokë jashtë gabaritit të ndërtesës;

- Në kuadër të parcelave nuk mund të prashihen objekte ndihmëse;
- Në kuadër të kompleksit të parashihen edhe vend parkimet e jashtme, shtigjet, trotuaret, kënde të lojërave për fëmijë, terrene sportive, mobiluar urban, etj.;
- Në kuadër të kompleksit të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;
- Arkitektura/dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të efijencës së energjisë, dhe ti përshtatet destinimit të ndërtesave të planifikuara;
- Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet ashtu që të jetë në harmoni me projektin arkitektonik dhe uji i strehëve duhet të derdhet brenda parcelës ndërtimore;
- Si dhe të bëhet aplikimi i të gjithave kushteve tjera urbane dhe arkitektonike të përcaktuara në kriteret dhe parametrat urban të Plani Rregullues "Tophane" dhe PZHU-së.

**V. Ndarja** / parcelimi i parcelave kadastrale **nr.4196-0; nr.4197-0; nr.4198-1; nr.4198-2; nr.4199-0; nr.4200-0; nr.4201-0; nr.4202-0; nr.4203-0; nr.4204-0; nr.4205-0; nr.4207-0 & nr.10353-6** ZK Prishtinë, do të realizohet bazuar në Plani i situacionit-"zgjidhja urbane", Situacionin e parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga plani rregullues, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01, dhe manualin e ndarjes, punuar nga gjeodeti i licencuar Muzafer Mustafa nga Prishtina, me numër të licencës nr.09.

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për ndarjen e parcelave kadastrale të lartcekura, sipas Planit të situacionit - "zgjidhja urbane" dhe "Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01", punuar nga kjo drejtori dhe manuali i ndarjes, punuar nga gjeodeti i licencuar. Procedura e ndarjes/parcelimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e ndarjes të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas vendimit të kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarëve, duke u bazuar edhe në Plani i situacionit - "zgjidhja urbane" dhe "Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01", punuar nga kjo drejtori dhe manualin e ndarjes, punuar nga gjeodeti i licencuar, të cilat janë pjesë përbërëse të këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

**VI. Bashkimi** i parcelave dhe pjesëve të parcelave kadastrale, **nr.4196-0; nr.4197-0; nr.4198-1; nr.4198-2; nr.4199-0; nr.4200-0; nr.4201-0; nr.4202-0; nr.4203-0; nr.4204-0; nr.4205-0; nr.4207-0; nr.4208-0; nr.4209-0; nr.4210-0 & nr.10535-1** ZK Prishtinë, do të realizohet bazuar në Plani i situacionit – "zgjidhja urbane" dhe në manualin e bashkimit, punuar nga gjeodeti i licencuar Muzafer Mustafa, me licencë nr.09.

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për bashkimin e parcelave kadastrale dhe pjesëve të parcelave të lartcekura, në një parcelë ndërtimore bazuar në Plani i situacionit-"zgjidhja urbane" & manualin e bashkimit të parcelave, punuar nga gjeodeti i licencuar Muzafer Mustafa, me licencë nr.09.

Procedura e bashkimit të do të realizohet bazuar në pëlqimin e përkthuar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për regjistrimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve. Bashkimi i parcelave të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore, me kërkesë të pronarëve, duke u bazuar në Plani i situacionit –"zgjidhja urbane" dhe manualin e bashkimit të parcelave, punuar nga gjeodeti i licencuar, të cilat do të jenë pjesë përbërëse të këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

**VII. Kompensimi** / shpronësimi me sipërfaqe ndërtimore i pjesëve të parcelave kadastrale **nr.4196-0** me  $S=63m^2$ ; **nr.4197-0** me  $S=123m^2$ ; **nr.4198-1** me  $S=42m^2$ ; **nr.4198-2** me  $S=39m^2$ ; **nr.4199-2** me  $S=26m^2$ ; **nr.4200-0** me  $S=37m^2$ ; **nr.4201-0** me  $S=49m^2$ ; **nr.4202-0** me  $S=68m^2$ ; **nr.4203-0** me  $S=20m^2$ ; **nr.4204-0** me  $S=4m^2$ ; **nr.4205-0** me  $S=1m^2$ ; **nr.4207-0** me  $S=24m^2$  & **nr.10353-6** me  $S=76m^2$ , dhe me sipërfaqe totale  $S=572m^2$ , të përfshira në hapësirë publike të planifikuar–rrugë të planit rregullues, për realizimin e ndërtimit të kompleksit me ndërtesa shumëbanesore dhe afariste, të realizohet si më poshtë:

Sipas llogarive në paragrafin IV, parcela ndërtimore e pjesës së bllokut urban "T5", është me sipërfaqe prej  $S=2,861m^2$ , ndërsa, sipërfaqja e pjesëve të parcelave kadastrale, të përfshira në rrugë të planifikuar, është  $S=572m^2$ , andaj bazuar në Vendimin 14nr.464/01-97987/22 dt.05.05.2022, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, kompensimi i pronës private të përfshirë në hapësirë me interes publik, mund të realizohet me koeficient të ndërtimit për sipërfaqet deri 20%, dhe sipas kësaj, kjo

sipërfaqe përcaktuar në përqindje (%) është,  $S=572/2,861 \times 100=19.99\%$ . Andaj, bazuar në vendimin e lartcekur, pronarët dhe investitori, do të kompensohen me sipërfaqen ndërtimore, llogaritur me koeficient të ndërtimit, si në vijim:  $S=2,861 \times 4.0=2,288m^2$ .

Kjo drejtori jep PËLQIM për kompensimin me koeficient ndërtimi të pjesëve të parcelave kadastrale, bazuar në vendimin e lartcekur. Kjo procedurë e kompensimit me koeficient ndërtimi, do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për arritjen e marrëveshjes definitive, në mes të bashkëpronarëve të parcelës dhe Komunës së Prishtinës, konkretisht Drejtorisë së Pronës të Komunës së Prishtinës.

Mos zbatimi i kësaj procedure sipas këtij paragrafi, nga bashkëpronarët dhe investitori, për arsye të ndryshme, detyron Drejtorinë e Urbanizmit dhe Mjedisit, të rishikojë sipërfaqet ndërtimore të ndërtesave shumë banesore dhe afariste, të përcaktuara me këtë vendim për caktimin e kushteve ndërtimore.

**VIII. Kyçja në infrastrukturë** - për marrjen e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina" aplikimi do të bëhet nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, i dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) Mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin - adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për energji elektrike dhe ujësjellës).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos" - Ngrohtorja e Qytetit sh. dhe PTK-ja.

**IX. Dokumentacioni ndërtimor** - projekti kryesor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, dhe të licencuar, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, Udhëzimin Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve, Udhëzimin Administrativ të MMPH-së Nr.08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinore, Rregulloren e MMPH Nr. 03/2016 mbi normat minimale teknike për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi, bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Situacionin - planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin - planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë;
- Situacionin - "zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesat e projektuara, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore - zejtare;
- Detajet e nevojshme në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë me përshkrimin e materialit të dymave dhe dritareve, në përpjesë 1:50;
- Projektin e organizimit të kompleksit, me rrugë, shtigje, mobilian urban, etj;
- Projektin e strukturës së ndërtimit - llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionim dhe detaje të nevojshme;
- Projektin e instalimeve elektro – energjetike, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafostacionit;
- Projektin e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Elaborati i "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim", bazuar në Vendimin 01 nr. 035-174324 dt. 12.07.2016 e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;

- *Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma;*
- *Elaboratin gjeomekanik në bazë të analizave në terrenit;*

**X. Dokumentacioni ndërtimor** - Elaborati për Masat e mbrojtëse nga zjarri hartuar nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet nga kjo drejtori në kompetencë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, të Komunës së Prishtinës, për sigurimin e "Deklaratë" për Masat e mbrojtjes nga zjarri.

*Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:*

- *Planin e mbrojtjes nga zjarri-elaboratin, të hartuar nga kompani apo individ i licencuar;*
- *Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);*
- *Situacionin-planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m<sup>2</sup>, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;*
- *Situacionin-"zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;*
- *Kushtet ndërtimore, të caktuara nga Drejtoria e Urbanizmit (kopje);*
- *Certifikatën e regjistrimit të biznesit të investitorit dhe të hartuesit të planit të mbrojtjes nga zjarri.*

Dokumentacioni ndërtimor - Elaborati për Leje Mjedisore Komunale, hartuar nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Urbanizmit dhe Mjedisit, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore.

*Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:*

- *Raporti për Leje Mjedisore Komunale, në tre (3)kopje në formë të shkruar dhe një (1) në formë elektronike;*
- *Certifikatën për regjistrimin e biznesit;*
- *Certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit;*
- *Kontratën për shfrytëzimin e parcelës, nëse parcela nuk është pronë e aplikuesit.*

**XI. Dokumentacioni ndërtimor** - elaborati për "Arkitekturë e qëndrueshme", i hartuar konform kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës, 01nr.031 – 185481 dt.14.08.20215, për të cilin është dhënë vlerësimi për rregullsi nga Sektori i Mjedisit dhe i Efiqencës i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mjedisit, në fazën e caktimit të kushteve ndërtimore, përmes shkresës zyrtare "Vlerësim në arkitekturë të Qëndrueshme", me referencë 05nr.352/10-54475/26 dt. 17.04.2026, me rastin e aplikimit për leje ndërtimore, aplikuesi obligohet të sigurojë rregullsinë dhe të sigurojë pëlqim në dokumentacionin ndërtimor – elaboratin për "Arkitektura e qëndrueshëm", i cili duhet të jetë pjesë përbërëse e dokumentacionit ndërtimor / projektit kryesor, të përshkruar si në paragrafin XI., të këtij vendimi, i hartuar bazuar në kushtet ndërtimore të përcaktuara me këtë vendim, dhe në kriteret e përcaktuara me Vendimin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës, 01nr.031 – 185481 dt.14.08.2015.

*Në rast të mos përmbushjes së kësaj kërkesë, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit obligohet të rishikojë vendimin për caktimin e kushteve ndërtimore, konkretisht përcaktimin e koeficientit të shfrytëzimit të parcelës ndërtimore (nga ISHP 40 + 10%, në ISHP 40%).*

**XII. Marrëveshja për infrastrukturë** – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të "Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01 nr. 434/01–0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin/investitorin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- *Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);*
- *Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore; së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;*
- *Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;*
- *Kontratën për bashkë investim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);*
- *Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);*
- *Kopjen e letërnjoftimit të kërkuarit/ve (bashkëpronarëve të parcelës-ave dhe investitorit);*

**XIII. Pagesa e taksës** për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas "Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01Nr.434/01 – 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor / projektin kryesor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

Pagesa e taksës administrative do të llogaritet edhe për rrënimin e ndërtimeve ekzistuese në kuadër të parcelës kadastrale, bazuar në gjendjen ekzistuese, incizimin gjeodezik dhe projektin ideor të atyre ndërtimeve, me pagesën e taksës së përcaktuar në pikën 5.9 të nenit 5 të rregullores së lartcekur dhe vendimit për lejimin e rrënit.

**XIV. Vlefshmëria** e vendimit të kushteve ndërtimore është një(1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë së tyre.

## **A r s y e t i m**

